



Korrik / Juli 2019

alban.

## Dilni në mbarë botën dhe i predikoni ungjillin çdo krijese!

(Mk 16,15)

**Kontakt:** Meinolf Wacker  
Kirchplatz 7  
59174 Kamen

**Tel.:** +49-172-5638432  
**E-mail:** [meinolf.wacker@go4peace.eu](mailto:meinolf.wacker@go4peace.eu)  
**Homepage** [www.go4peace.eu](http://www.go4peace.eu)

---

**Bëhu dhuratë!  
Be a gift!**

Të dashur miq të fjalës!

Për herë të parë e takova atë në Sinagogën e Aushvic-it. Ajo po angazhohej si një vullnetare nga Gjermania për të “shëruar” plagët e Europës. Ajo po drejtonte një grup nxënësish gjermanë nëpër një ekspozitë e cila tregonte për jetën e hebrenjve në Aushvic. Kur ajo po tregonte historinë e miqësisë midis një vajze të re dhe një hebreje gjatë kohës së pushtimit të mijëvjeçarit të kaluar, mua më erdhën lotë në sy. Zemra e saj digjej për një „Njerëzi“ dhe për jetën e secilit prej njerëzve.

Po në të njëjtin vit ajo mori pjesë në një ndër kampet Go4peace. Kur ajo ishte nxënëse, ajo kishte jetuar një vit në Paris dhe aty kishte mësuar gjuhën frënge. Në aktin e saj vullnetar në Poloni, ajo, rrënjët e së cilës shkonin në Schlesien, kishte mësuar gjuhën polake. Më vonë, mora vesh se ajo kishte marrë pjesë në një seminar për takimet e të rinjve frëngo-gjermano-polak. Një europiane e vërtetë.

Përherë shihja në sytë e saj një shkëlqim të thellë. Zemra e saj digjej nga dashuria për çdo njeri, por mbi të gjithë, për të vegjëlit. Në mënyrë shumë modeste ajo tregonte afërsinë e saj dhe hapte një derë për të tjerët. “Ishte shumë vonë, 11:00 e natës, unë po prisja në stacionin e trenit, ishte errësirë. Një grua e re mu afrua. Unë nuk e dija në fillim a të rrija apo të largohesha. Por ajo më foli. Ajo më la të kuptoja, që portofoli i saj ishte vjedhur dhe që ishte trazuar nga disa njerëz në stacion. Mua më erdhi në mend moto-ja: *Shëndërroje errësirën në dashuri!* Kjo Moto më prekte. Unë nuk e dija nëse historia e kësaj gruaje ishte e vërtetë apo jo. Por, unë pashë: Në atë moment ajo nuk donte të ishte vetëm. Kështu unë qëndrova me të dhe po bisedonim. Më vonë i dhashë para për trenin e saj. Kur ne mbaruam bisedën, ajo më pyeti me falenderim për emrin tim. Kur treni im erdhi dhe unë po hipja në tren, dëgjova papritur emrin tim „Tereza!“ dhe më pas një „Faleminderit nga zemra!“

„Dilni në mbarë botën dhe i predikoni ungjillin çdo krijese!“ – Jeta e Terezës flet – shpesh pa fjalë. Ajo është një dhuratë për ata me të cilët ajo takohet. **Bëhu dhuratë! – Be a gift!**